



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.81

6 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9760 datë 21.6.2007	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar	2391
Dekret nr.5382 datë 27.6.2007	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	2394

LIGJ
Nr.9760, datë 21.6.2007

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8308, DATË 18.3.1998 “PËR
TRANSPORTET RRUGORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 3.20 shtohen pikat 3.21, 3.22, 3.23 e 3.24 me këtë përmbajtje:

“3.21. Veprimtaria e operatorit të transportit rrugor të mallrave nënkupton veprimtarinë e çdo ndërmarrjeje, që transporton mallra për të tretë dhe me qira, me anë të një mjeti ose kombinimi mjetes motorike.

3.22. Veprimtaria e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve nënkupton veprimtarinë e çdo ndërmarrjeje, që operon me anë të mjeteve motorike, të konstruara dhe të pajisura në mënyrë të tillë, që të jenë të përshtatshme për të transportuar më shumë se nëntë persona, përfshirë drejtuesin e mjetit dhe të destinuara për këtë qëllim, që kryen shërbime transporti udhëtarësh për kategoritë publike ose të veçanta të përdoruesve, kundrejt pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori i transportit.

3.23. Ndërmarrje nënkupton çdo person fizik ose juridik për qëllime fitimi apo jo, çdo shoqatë ose grup individësh, pa personalitet juridik, me qëllim fitimi ose jo, apo çdo organ zyrtar, që ka personalitetin e vet ligjor ose varet nga një organ, që e ka këtë personalitet.

3.24. Taksimetër nënkupton një instrument matës, i cili, në përputhje me karakteristikat e mjetit ku vendoset dhe tarifat për të cilat fiksohet, llogarit, në mënyrë automatike dhe të vazhdueshme, shumën që do të paguhet nga përdoruesi i mjetit publik, i quajtur taksi, në bazë të distancës së përshkruar dhe/ose kohës, për të cilën mjeti është përdorur.”.

Neni 2

Neni 6 riformulohet si më poshtë:

“Neni 6

Hyrja në treg e operatorëve të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve kërkon plotësimin e disa kushteve, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave për:

1. Pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve nëpërmjet licencës, e cila jepet bazuar në kërkesat e mëposhtme:

- a) në kompetencën profesionale;
- b) në reputacionin e mirë;
- c) në besueshmërinë financiare.

2. Njohjen e ndërsjellë të diplomave, certifikatave dhe të ndonjë dokumenti tjetër zyrtar kualifikimi të vetë operatorëve të transportit.”.

Neni 3

Në nenin 15, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) bashkive qendër rrethi me qendrat arkeologjike, historike dhe turistike brenda rrethit.”.

Neni 4

Në nenin 16 shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) bashkive qendër të rretheve të ndryshme brenda një qarku dhe bashkisë jo qendër rrethi, me bashki qendër të një rrethi tjetër brenda një qarku.”.

Neni 5

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

a) Rrjeti i linjave ndërqytetëse brenda një qarku dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut. Licenca për këto linja jepet nga kryetari i bashkisë, ku ka selinë subjekti transportues.

b) Rrjeti i linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve të ndryshme miratohet me urdhër të ministrit.

c) Për rastet e tjera, të përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 16 të ligjit, linjat miratohen me urdhër të ministrit, me propozimin e këshillit të qarkut.

ç) Për rastet e tjera, të përcaktuara në shkronjën "ç" të nenit 16 të ligjit, linjat miratohen me urdhër të ministrit.

Ministri, në përputhje me nenin 5 të ligjit, përcakton institucionin që lëshon licencën dhe miraton numrin e orareve për linjat ndërqytetëse, sipas shkronjave "b", "c" dhe "ç" të këtij neni. ".

Neni 6

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet.

Kriteret për caktimin e numrit maksimal të taksive, në shkallë vendi, vendosen me udhëzim të ministrit.

Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, duke respektuar kriterin e numrit, siç përmendet në paragrafin e mësipërm të këtij neni.

Licenca për shërbimin taksi jepet me afat 5 vjet, me të drejtë rinovimi automatikisht, kur subjekti ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.”.

Neni 7

Në nenin 36 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.”.

Neni 8

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Taksimetrat duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore (OIML), për sa u përket specifikimeve të përgjithshme e të veçanta dhe/ose në përputhje me kushtet e vendosura në standardet e BE-së për tipin e miratuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, si autoriteti përgjegjës, në përputhje me paragrafin e mësipërm, për tipin e miratuar kryen verifikimin fillestar të taksimetrit.

Taksimetri duhet të jetë i kalibruar dhe i vulosur nga autoriteti përkatës, si dhe duhet të jetë në gjendje të rregullt pune dhe i vendosur në vend të dukshëm.”.

Neni 9

Në nenin 37, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë territorit të rrethit ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:

- a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;
- b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë pronotuar dhe/ose rezervuar më parë në vajtje dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.”.

Neni 10

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm për ndërmarrjet që kryejnë transport mallrash për të tretë dhe me qira, brenda vendit, me anë të mjeteve motorike ose të kombinimeve të mjeteve.

Kapaciteti maksimal i lejuar i transportimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Këshilli i Ministrave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave, të cilat ngarkohen me zbatimin e ligjit, të marrin masa për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin 5381, datë 26.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5382, datë 27.6.2007

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|---------------------------------------|
| 1. Teuta Gani Prifti (Qemo) | 29. Enkeleda Shefqet Militzer (Ferra) |
| 2. Rea Edgar Prifti | 30. Claudio Sotir Çerma |
| 3. Kastriot Rexhep Baraku | 31. Loreta Vasil Cenollari (Bano) |
| 4. Ina Ismail Memetaj | 32. Peggy Shkëlqim Cenollari |
| 5. Elide Kol Gurra | 33. Esemeralda Vasil Katia (Xafa) |
| 6. Iris (Irisi) Rapo Malo | 34. Irena Tase Duka |
| 7. Ornela Ymer Derani (Rusheku) | 35. Leonora Neim Kretschmer (Hysko) |
| 8. Brixhilda Gëzim Berisha (Meta) | 36. Majlinda Shyqeri Jazxhi (Kalaja) |
| 9. Rahime Kujtim Berisha | 37. Kleopatra Dervish Thomas (Avdo) |
| 10. Bleona Kujtim Berisha | 38. Anila Esat Xhelilaj |
| 11. Flori Kujtim Berisha | 39. Artur Besnik Fëllanxa |
| 12. Fatbardha Dhimitër Kameraj (Prifti) | 40. Ali Njazi Cora |
| 13. Naim Vahid Kameraj | 41. Petrit Prekë Weber (Ndrezaj) |
| 14. Lulzim Vahid Kameraj | 42. Skënder Ram Krasniqi |
| 15. Josif Leo Mazzi (Nako) | 43. Ilir Koço Simo |
| 16. Luis Josif Mazzi | 44. Jürgen Ilir Simo |
| 17. Cicile (Ççile) Luigj Mazzi (Nako) | 45. Valbona Ramadan Simo (Metko) |
| 18. Vasil Sotir Duria | 46. Hari Ilir Simo |
| 19. Christian Vasil Duria | 47. Lekë Rifat Ukimeraj |
| 20. Clea Vasil Duria | 48. Franc Gjon Margjini |
| 21. Donika Ligor Duria (Risto) | 49. Eral Ndue Susaj |
| 22. Manush Ali Çuterraj | 50. Ardian Stefan Hyka |
| 23. Samet Manush Çuterraj | 51. Gerti Bardhyl Këllezi |
| 24. Fatmire Ahmet Çuterraj (Smakaj) | 52. Mimoza Haxhi Blaschka (Kacmali) |
| 25. Elinda Manush Çuterraj | 53. Xhemal Ahmet Perllaku |
| 26. Silvana Qazim Redo (Hoxha) | 54. Mimoza Myslim Gjergji |
| 27. Klea Shpëtim Redo | 55. Brunilda Naim Reçi (Qosja) |
| 28. Lisja Shpëtim Redo | 56. Nensi Agron Reçi |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 4.7.2007
 Doli nga shtypi më 6.7.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2007

Çmimi 8 lekë